

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vjeshta shuan flakët! “Mbrojtja”: Asnjë vatër aktive. U fikën zjarre në Dibër, Lezhë, Elbasan...
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/vjeshta-shuan-flaket-mbrojtja-asnje-vater-aktive-u-fiken-zjarre-ne-diber-i585766
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 09:41:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 09:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	71e22d02c4100e59240501e6f4754d76629741f6f3e286b94dcdab18f0cdfac3
TEKSTI	b7baa5c75e1e11531bddeaabb8695e5e665f9448cdfa39a157edbb79672f33cc
PAMJA	461a9082ba2419f38da5f72e11053e1d8d0760a65318a2434793424b9ce3e018

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6b75a805094ffc0b2c359b74ae23b42b2600e493af464bf00c98c7643c642060
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6b75a805094ffc0b2c359b74ae23b42b2600e493af464bf00c98c7643c642060>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1e Lindjet vazhdojnë të bien, bonusi i bebes drejt rristrukturimitNuk justifikoheshin me të ardhurat, sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj drejtuesveHaxhiu e shpall të k fundit

Vjeshta shuan flakët! “Mbroytja”: Asnjë vatër aktive. U fikën zjarre në Dibër, Lezhë, Elbasan...

13 Shtator 2026, 11:45Sociale TEMA



Vjeshta shuan flakët! “Mbroytja”: Asnjë vatër aktive.

Situata e zjarreve në vend paraqitet e qetë, pasi gjatë 24 orëve të fundit janë shuar të gjitha 10 vatrat e raportuara.

Ministria e Mbrojtjes bën me dije se aktualisht nuk ka asnjë vatër aktive apo nën mbikëqyrje. Zjarret janë shuar në qarqet Dibër, Lezhë, Elbasan, Gjirokastrë dhe Fier, falë angazhimit të forcave zjarrfikëse, bashkive, policisë, shërbimit pyjor dhe Forcave të Armatosura.

Në operacione janë angazhuar 174 forca operacionale dhe 14 automjete zjarrfikëse, ndërsa FA kanë mbështetur me 27 efektivë, tre mjete dhe një ambulancë.

Ndërhyrjet janë fokusuar në izolimin dhe shuarjen e vatrave, duke parandaluar përhapjen e flakëve në zona të banuara dhe sipërfaqe me bimësi. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile vijon monitorimin e situatës në të gjithë territorin, ndërsa strukturat mbeten në gatishmëri për çdo emergjencë.

Njoftimi i Ministrisë së Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes – përditësim mbi situatën e zjarreve gjatë 24 orëve të fundit

Raport i situatës së zjarreve – 13.09.2026, ora 09:00

Gjatë 24 orëve të fundit, në territorin e vendit janë raportuar 10 vatra zjarri, të cilat janë shuar plotësisht. Aktualisht nuk ka vatra aktive dhe as vatra nën mbikëqyrje.

Për menaxhimin dhe shuarjen e vatrave janë angazhuar në total 174 forca operacionale vendore dhe lokale dhe 14 automjete zjarrfikëse. Forcat e Armatosura kanë mbështetur operacionet me 27 efektivë, 3 mjete dhe 1 ambulancë.

Në Qarkun Lezhë, vatra në fshatin Gallatë, Bashkia Kurbini, e ardhur nga territori i Bashkisë Mat, rezulton e fikur.

Në Qarkun Elbasan, zjarri në Librazhd Katund, i cili preku bimësi me pisha, është shuar.

Në Qarkun Gjirokastrë, vatra në Bularat, Bashkia Dropull, është shuar pas angazhimit të strukturave vendore, policore dhe të Forcave të Armatosura. Në operacion u përfshinë 18 efektivë të MZSH me 3 mjete zjarrfikëse, 8 forca bashkiake, 10 forca policore, si dhe 27 efektivë të FA me 3 mjete dhe 1 ambulancë.

Në Qarkun Dibër, janë shuar vatrat në Lundre–Madhesh, Cerrujë/Mali i Allushit dhe Selishtë. Për operacionet janë angazhuar forca të MZSH-së, shërbimit pyjor, bashkive dhe vullnetarë.

Në Qarkun Fier, janë shuar vatrat në Bitaj, Bashkia Lushnje, dhe Rërës, Bashkia Patos.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) vijon të ndjekë në mënyrë të pandërprerë situatën në të gjithë territorin e vendit, në koordinim të ngushtë me prefekturat, bashkitë dhe të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Kapacitetet operacionale mbeten të angazhuara në terren dhe në gatishmëri për të ndërhyrë aty ku situata e kërkon, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave, pasurisë së qytetarëve dhe mjedisit.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Stuhia godet Elbasanin, uji pushton banesa, bodrume dhe parkime nëntokësore](#)

11:00 Sociale / 1 koment

[Salla: Arsimi profesional bujqësor, lidhje e drejtpërdrejtë me prodhimin dhe biznesin](#)

21:10 Sociale

[Hapësirat e pashfrytëzuara në shërbim të komunitetit - Bashkia e Tiranës i kthen në kënde lojërash dhe mjedise çlodhjeje](#)

19:40 Sociale / 3 komente

[Specialistët e Kadastrës “zbarkojnë” në Piqeras, po punohet për evidentimin e regjistrit kadastral](#)

19:10 Sociale / 4 komente

[20 shkolla të Tiranës me kamera inteligjente](#)

17:00 Sociale / 3 komente

[Check Up falas mbi 35 vjeç - ISHP: Analizat do të pasqyrojnë faktorët e rrezikut në popullatë](#)

16:10 Sociale / 3 komente

[120 notarë kalojnë nga Ksamili në Korfuz](#)

15:20 Sociale / 4 komente

[Korça drejt gazifikimit, nisin studimet ne terren: Projekti pilot, alternativë e re për ngrohjen dhe energjinë](#)

11:30 Sociale / 10 komente

[Reshjet e shiut lehtësojnë situatën e zjarreve në vend, 31 vatra të shuara](#)

11:18 Sociale / 1 koment

[Nesër në Apolloni të Fierit, Gjergj Luca hap kompleksin e trete Fish City në Shqipëri](#)

21:19 Sociale /6 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Unë jam me Petrit Malajn](#)

14:45 Blog /59 komente

[‘Det’ pjesëmarrësish në ‘Marshin për liri’ në Prishtinë: ...](#)

15:15 Rajoni /66 komente

[BE reagon para vendimit për Thačin dhe ish-krerët e UÇK-s...](#)

14:30 Rajoni /31 komente

[John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?](#)

11:40 Blog /20 komente

[VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...](#)

10:02 Politika /7 komente

Blog Tema

[EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliaj deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"](#)

10:30 Blog /1 koment

[Demokracia jonë pa hardware dhe software?!](#)

08:23 Blog /6 komente

[Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike](#)

18:43 Blog

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)

- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.